REPUBLIKA E KOSOVËS | REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT - TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 377/17
09.10.17
PRISHTINË - PRIŠTINA

## ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Një ankesë kundër: **Ministria e Zhvillimit Ekonomik**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **213-17-1874-211**

Sa i përket tenderit për **Krijimi i Atllasit Elektronik për Infrastrukturën Telekomunikuese Brezgjere ne Kosovë**

# ANKESË

## 1. Identifikimi i ankuesit*

*Geo&Land sh.p.k*
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

*Rr. Muharrem Fejza C15/11 Nr.7*
(Adresa)

*Prishtine*
(Vendi)

*10000*
(Kodi postar)

*+37744*[redacted]
(Numri Telefonit)

(Numri i Faks-it)

*Ymer Kuka*
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

[redacted]*kosova.com*
(Adresa elektronike)

*09.10.2017*
(Data e parashtrimit të kërkesës)

Geo&Land sh.p.k. Muharrem Fejza 10000 Prishtinë

(Nënshkrimi dhe vula)

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

## 2. Identifikimi i avokatit

*Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me* PROKURË.

*Shëno të dhënat si në vijim:*

Ne kemi pranuar njoftimin mbi anulimin e aktivitetit të prokurimit.
Brenda afatit ligjor kemi dorëzuar kërkesën për rishqyrtim nga AK.

## 6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

*Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.*

**Shkeljet e pretenduara sipas LPP** *Ligji Nr. 04/L-042 I ndryshuar dhe plotësuar me Lgjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092 (Versioni i Konsoliduar)*

1. Neni 6 paragrafi 1
2. Neni 7
3. Nenin 56, paragrafi 1
4. Neni 59
5. Neni 60
6. Neni 68
7. Neni 69

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë e rrejshme ose mashtruese.*

## 7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

*Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.*

### Hyrje

Ne kemi dorëzuar ofertën tonë në formë fizike për tenderin me titull "Krijimi i Atllasit elektronik për infrastrukturën telekomunikuese brezgjere në Kosovë". Fillimisht, dëshirojmë të shprehim falënderimin tonë ndaj AK, për korrektësinë tuaj gjatë vlerësimit të ofertës në herën e parë, gjegjësisht për njoftimin tuaj të datës 19.07.2017, ku ne si OE jemi shpallur te përgjegjshëm, rrjedhimisht fitues te këtij AP. Mirëpo, me datë 19.09.2017 kemi pranuar njoftimin nga AK mbi eliminim tonë nga ky AP me arsyetimin si ne vijim: Analisti i Sistemit – nuk i ka plotësuar kërkesat sipas vendimit të OShP-së Nr.262/17, po ashtu edhe kërkesat për harduer (një Kompjuter Workstation, një Monitor dhe pesë Llaptop), janë dhënë me çmime të ndara por karakteristikat teknike nuk përshtaten me kërkesat e specifikuara në dosjen e tenderit, po ashtu edhe plani dinamik i realizimit të projektit – i propozuar nga 1 Korriku 2017 deri më 30 Qershor 2018 nuk përputhet në tërësi me kërkesën e AK (14 muaj).